



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 870/2 prot.

Tiranë, më 17.5.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.617/1, datë 02.04.2001.

SHOQËRISË “SHEBENIK” SH.P.K

Rruga “Çermenikë”, banesë private, Kati i parë, Librazhd, Elbasan.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “SHEBENIK” sh.p.k. është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.617/1, datë 02.04.2001, për mineralin kuarc, në Objektin “Lunik”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 2054/2, datë 26.04.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 870/1, Prot., datë 29.04.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.617/1, datë 02.04.2001, për mineralin kuarc, në Objektin “Lunik”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, pasi subjekti nuk zotëron leje mjedisore aktive për objektin minerar të sipërcituar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1,

gërma "h" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.617/1, datë 02.04.2001, për mineralin kuarc, në Objektin "Lunik", Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", kenë të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.617/1, datë 02.04.2001, për mineralin kuarc, në Objektin "Lunik", Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENKELTA MIÇAJ

